5.2 Autoriteti Kontraktues/MEI do të bëjë te gjitha përpjekjet për të siguruar leshimin te gjitha autorizimeve, pelqimeve, liçensave dhe miratimeve te nevojshme lidhur me hyrjen ne fuqi dhe permbushjen e kesaj Marreveshjeje, ne afatin e duhur ne perputhje me grafikun e rene dakord per zbatimin.

5.3 Autoriteti Kontraktues/MEI do të bëjë te gjitha përpjekjet për të siguruar leshimin te gjitha autorizimeve, pelqimeve, liçensave dhe miratimeve te nevojshme per ndertimin e rruges zevendesuese te Moglices M15.

## 6. MOS HEQJA DORE

6.1 Asnje gje e rene dakort ne kete Marreveshje nuk do te shkarkoje Autoritetin Kontraktues/MEI nga pergjegjesite e tij sipas Marreveshjes se Konçesionit, duke perfshire por pa u kufizuar ne pergjegjesine per ndertimin brenda afatit te Infrastruktures Zevendesuese.

## 7. KOMUNIKIMI DHE BASHKEPUNIMI MIDIS PALEVE

7.1 Palet duhet te komunikojne vazhdimisht dhe duhet t'i sigurojne njera tjetres te gjithe informacionin e nevojshem per permbushjen e detyrimeve te Pales tjeter sipas kesaj Marreveshje. DHP-ja do te kete te drejten t'i kerkoje Autoritetit Kontraktues/ MEI dhe ARrSh-se cdo informacion teknik i cili mund te nevojitet ne procesin e projektimit ose ne lidhje me pergatitjen e dokumentave te tenderit.

7.2 Palet duhet te bashkepunojne si te jete e nevojshme dhe te ofrojne te gjithe ndihmen e arsyeshme per te siguruar nje ndertim, kolaudim dhe testim ne kohen e duhur, te sigurt dhe korrekt te Infrastruktures Zevendesuese.

projektimit jane ne perputhje me ato te vendosura ne Aneksin 1 dhe afati i ketij miratimi do te jete ne perputhje me grafikun e punimeve te rrugeve zevendesuese, sic parashikohet ne Aneksin 2 bashkelidhur.

1.5 DHP-ja do te siguroje/paraqese nje projekt te rishikuar per cdo ndryshim ne projektin e propozuar, vetem nese ky projekt nuk eshte ne perputhje me standardet e percaktuara ne Aneksin 1 dhe nese nuk perfshihet ose percaktohet ne Aneksin 1, me standardet teknike shqiptare. Ne rast se ka mosperputhje midis Aneksit 1 dhe standardeve teknike shqiptare, Aneksi 1 do te mbizoteroje.

## 2. TENDERIMI I INFRASTRUKTURËS ZËVËNDËSUESE

2.1 Ne varesi te zbatimit te Klauzoles 4, DHP-ja do te kryeje nje proces tenderimi te pavarur, rreptesisht ne perputhje me rregulloret e DHP-se/Statkraft, per Infrastrukturen Zevendesuese, sic percaktohet ne piken (ii) te shkronjes (G) te Hyrjes se kesaj Marreveshjeje. DHP-ja do te percaktoje rregullat dhe kriteret per perzgjedhjen e ofertuesit fitues sic mund te jene te zbatueshme per tenderin dhe sic DHP-ja e konsideron te pershtatshme per tenderin specifik. Te gjitha procedurat e tenderit do te monitorohen nga nje person i autorizuar i Autoritetit Kontraktues/MEI.

2.2 DHP do te pergatise nje set te dokumentash, duke perfshire termat e references dhe specifikimet teknike ne lidhje me procesin e tenderimit.

2.3 DHP, perpara firmosjes se kontratave per punimet e ndertimit, do te informoje Autoritetin Kontraktues/ MEI per fituesin e tenderit dhe vleren e kontrates.

## 3. NDERTIMI I RRUGES ZEVENDESUESE TE MOGLICES M15

3.1 Ne varesi te zbatimit te Klauzoles 4, DHP merr persiper te kryeje ndertimin e Rruges Zevendesuese M15. DHP-ja do t'i siguroje Autoritetit Kontraktues/MEI analizen e detajuar te kostos se projektimit dhe te punimeve te ndertimit perfshire ketu punimet e pa-parashikuara qe evidentohen gjate ndertimit te Rruges Zevendesuese te Moglices M15.

3.2 Punimet e ndertimit per rrugen zevendesuese te Moglices M15, do te kryhen ne perputhje me standardet teknike te miratuara dhe nga subjekte te licencuara.

3.3 DHP do t'i siguroje Autoritetit Kontraktues/ MEI kopje te termave te garancise, sic percaktohen ne kontraten per punimet e ndertimit dhe do te marre parasysh pikepamjet/mendimet e Autoritetit Kontraktues/ MEI lidhur me ankesa te mundshme kundrejt kontraktorit lidhur me cilesine e rruges dhe defektet e punimeve te ndertimit brenda periudhes se garancise.

## 4. SHTESA E KONTRATES SE KONCESIONIT

4.1 Projektimi, tenderimi dhe ndertimi i Infrastruktures Zevendesuese nga DHP-ja, te percaktuara ne Klauzolat 1, 2 dhe 3 sa me lart , do te kryhen nga DHP-ja me kusht qe Palet ne Marreveshjen se Koncesionit do te nenshkruajne nje shtese te Kontrates se Konçesionit me qellim shkarkimin nga pergjegjesia te MEI ne cilesine e Autoritetit Kontraktues per ndertimin e Infrastruktures Zevendesuese kundrejt nje kompensimi te drejtë dhe te kenaqshem per Koncesionarin (DHP dhe Statkraft A.S) per kostot shtese e të arsyeshme, që tejkalojnë ate te percaktuar sipas kushteve te percaktuara ne klauzolen 7.2.6 pika (i), (iii) te Marreveshjes se Koncesionit, kosto shtese qe do t'i shkaktohen DHP-se per marrjen persiper te detyrimit per projektimin, tenderimin dhe ndertimin e Infrastruktures Zevendesuese, pas shuarjes nga DHP

Marreveshjeje, e cila ekziston ne daten e ketij perfundimi. Per me teper, Klauzolat 6, 8 dhe 9 do te mbeten edhe pas perfudnimit te kesaj Marreveshjeje.

**NE PRANINE E PALEVE,** Kjo Marreveshje eshte nenshkruar rregullisht nga perfaqesuesit e autorizuar te Paleve ne daten, muajin dhe vitin e percaktuar mesiper.

**MINISTRIA E ENERGJISE DHE INDUSTRISE**

**SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

Nga: ______________________

Emri: Ilir Bejtja

Pozicioni: Zv. Minister

**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**

Nga: ______________________

Emri: BASHKIM XHUKA

Pozicioni: ______________________

**DEVOLL HYDROPOWER SH.A.**

Nga: ______________________

Emri: Ola By

Pozicioni: CEO

## 8. NJOFTIMET

8.1 Çdo njoftim apo komunikim tjeter nga nje Pale ne Palen tjeter qe kerkohet ose lejohet te kryhet sipas parashikimeve te kesaj Marreveshje do te: (i) kryhet ne gjuhen angleze dhe shqipe, duke mbizoteruara variant ne gjuhen angleze; (ii) ne forme te shkruar; (iii) dergohet personalisht (dorazi) ose dergohet nepermjet postes rekomande ose korrier ne adresen e Pales tjeter qe percaktohet meposhte ose ne nje adrese tjeter qe Pala tjeter me njoftim kerkon, ose nepermjet faksimiles (me konfirmim marrje) ne numrin e faksimiles te Pales tjeter qe tregohet meposhte ose ne nje numer tjeter faksimile qe Pala tjeter do te kerkoje me njoftim; dhe (iv) te shenohet ne vemendje te personit(ve) te percaktuar meposhte ose te persona tjere qe Pala tjeter do te kerkoje me njoftim.

**AUTORITETI KONTRAKTUES/MEI:**

Ne vemendje te: Te nderuarit Minister
Bulevardi Deshmoret e Kombit, 1001
Tirane, Shqiperi
Faksimile: +355

**DEVOLL HYDROPOËER SH.A.:**
Ne vemendje te: Drejtorit te Pergjithshem
Rruga "Papa Gjon Pali II"
ABA Business Centre, zyra # 1204
Tirana, Albania

Facsimile: +355 42 400 734

**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**
Ne vemendje te: Drejtorit te Pergjithshem
Rruga "Sami Frasheri, nr. 33
Tirane, Shqiperi
Faksimile: + 355 4222 3 600

## 9. TE NDRYSHME

9.1 Kjo Marreveshje e shkruar perben te gjithe çka palet kane rene dakord mbi çeshtjen ne fjale. Çdo ndryshim apo modifikim i kushteve te kesaj Marreveshje nuk do te jete i vlefshem perveç kur behet me shkrim dhe nenshkruhet nga te dyja palet.

9.2 Kjo Marreveshje do te zbatohet sipas legjislacionit shqiptar. Cdo mosmarreveshje qe mund te linde prej saj do te zgjidhet nga Arbitrazhi ne perputhje me dispozitat e Klauzoles 13.3 te Marreveshjes se Koncesionit.

9.3 Kjo Marreveshje nenshkruhet ne 3 kopje origjinale ne gjuhen angleze dhe 3 kopje origjinale ne gjuhen shqipe. Ne rast mosperputhshmerie midis dy versioneve, versioni anglisht do te prevaloje.

9.4 Në rast se brenda afatit të parashikuar në pikën 4.2, palët nuk arrijnë të nënshkruajnë, të miratojnë dhe të ratifikojnë shtesën e Kontratës së Koncesionit, kjo Marrëveshje do të perfundoje dhe pasketaj Palet nuk do te kene te drejta dhe detyrime sipas kesaj Marreveshjeje, pervec ndonje te drejte per tu ankuar perkundrejt Palet tjeter per shkelje te kesaj

**SHTOJCA E PARE**

**E MARREVESHJES**

**"Në lidhje me projektimin dhe tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese (Rrugët dhe Urat) dhe ndërtimin e rrugës M15 të Infrastrukturës Zëvendësuese të Moglicës"**

**Date 14.02.2014**

Kjo Shtojce e pare ("**Shtojca**") e marreveshjes "Në lidhje me projektimin dhe tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese (Rrugët dhe Urat) dhe ndërtimin e rrugës M15 të Infrastrukturës Zëvendësuese të Moglicës" ("**Marrëveshja e Infrastrukturës Zëvendësuese**") lidhet sot, me 17.10, 2014, ndermjet:

1. (A) MINISTRIA E ENERGJISE DHE INDUSTRISE, (AUTORITETI KONTRAKTUES/*MEI*) DHE

   **(B) AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR (*ARA*),**

   dhe

2. **DEVOLL HYDROPOWER SH.A,** një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën Rr. "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center, Zyra nr. 1204, Tiranë, Shqipëri dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit e Republikës së Shqipërisë **("DHP"),**

Secili prej Autoritetit Kontraktues/MEI, ARA dhe DHP do të quhen individualisht "**Pala**" dhe bashkërisht "**Palët**".

Çdo fjalë me gërmë të madhe e cila nuk është përkufizuar në kete Shtojce do të ketë kuptimin qe i është dhënë kësaj fjale në Marrëveshjen e Infrastrukturës Zëvendësuese dhe Kontratën e Koncesionit, siç përkufizohet më poshtë.

**HYRJE**

MEQENËSE:

(A) Më datë 14.02.2014, Palët nënshkruan Marrëveshjen e Infrastrukturës Zëvendësuese, sipas të cilës, DHP mori përsipër projektimin, tenderimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese nëse palët do të nënshkruanin një shtesë të Marrëveshjes së Konçesionit të Devollit, ku do te parashikohej që DHP do të merrte përsipër përgjegjësine për këto aktivitete nga Autoriteti Kontraktues/MEI në rrethana të caktuara.

(B) Neni 4.2 i Marrëveshjes së Infrastruktures Zëvendësuese parashikon se Autoriteti Kontraktues/MEI zotohet të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme me qëllim që shtesa e kësaj Marrëveshje të Konçesionit, siç është rënë dakord paraprakisht ndërmjet palëve, të miratohet nga Qeveria Shqiptare dhe të ratifikohet nga Parlamenti Shqiptar jo më vonë se data 30 Qershor 2014.

(C) Në datën e nënshkrimit të kësaj Shtojce, Palët janë ende duke diskutuar për shtesën e Kontratës së Koncesionit në fjalë; pra, afati për aprovimin dhe ratifikimin e shtesës së tretë të Marrëveshjes së Konçesionit siç përcaktohet në nenin 4.2 te Marrëveshjes së Infrastrukturës Zëvendësuese ka kaluar.

(D) Pavarësisht nga sa më sipër, DHP ka vazhduar të kryejë aktivitete dhe të plotësojë detyrimet e përcaktuara në Marrëveshjen e Infrastrukturës Zëvendësuese deri në datën e kësaj Shtojce, si dhe Autoriteti Kontraktues/MEI i ka pranuar dhe miratuar aktivitetet në fjalë.

(E) Palët konfirmojnë qe ata janë dakord se Marrëveshja e Infrastrukturës Zëvendësuese mbetet e vlefshme dhe në fuqi për periudhën pas 30 Qershorit 2014 dhe se janë të gatshëm të shtyjnë kohëzgjatjen e Marrëveshjes së Infrastrukturës Zëvendësuese dhe afatin e miratimit dhe ratifikimit të shtesës së 3-të të Marrëveshjes së Konçesionit nëpërmjet kësaj Shtojce.

**PËR KËTË ARSYE,** duke marrë parasysh sa më lart, Palët bien dakord si vijon:

## 1. NDRYSHIMET

Neni 4.2 i Marrëveshjes së Infrastrukturës Zëvendësuese ndryshohet si vijon:

> "4.2 Autoriteti Kontraktues/MEI zotohet të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme me qëllim që kjo shtesë e Marrëveshjes së Konçesionit, siç është rënë dakord paraprakisht ndërmjet Palëve, të miratohet nga Qeveria Shqiptare dhe të ratifikohet nga Parlamenti Shqiptar jo më vonë se data 30 Dhjetor 2014".

## 2. MOSHEQJA DORE

Asgjë sipas kësaj Shtojce të Marrëveshjes së Infrastrukturës Zëvendësuese nuk do të shkarkojë Autoritetin Kontraktues/MEI nga përgjegjësitë e tij sipas Marrëveshjes së Konçesionit, duke përfshirë por pa u kufizuar në përgjegjësinë për ndërtimin brenda afatit të Infrastrukturës Zëvendësuese.

## 3. TE NDRYSHME

Kjo Shtojce nënshkruhet në 3 kopje origjinale në gjuhën angleze dhe 3 kopje origjinale në gjuhën shqipe. Në rast mospërputhje midis dy versioneve, versioni anglisht do të mbizotërojë.

Asnjë dispozitë tjetër e Marrëveshjes, përveç nenit 4.2, nuk do të preket nga kjo Shtojce dhe se të gjitha dispozitat e tjera do të kenë të njëjtën fuqi dhe do të aplikohen sipas përcaktimeve të bëra në Marrëveshje.

Kjo Shtojcë është nënshkruar në mënyrë të rregullt nga përfaqesuesit e autorizuar të Palëve si më poshtë, në daten, muajin dhe vitin të përcaktuar me lart.

**MINISTRIA E ENERGJISE DHE INDUSTRISE**

**E REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

Nga:____________________________

Emri: Damian Gjiknuri

Pozicioni: Minister

**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**

Nga:____________________________

Emri: Doshamir Xhika

Pozicioni: Drejt. Pergj. ARR.SH.

**DEVOLL HYDROPOWER SH.A**

Nga: Devoll Hydropower SH.A

Emri: Ola By

Pozicioni: CEO

**SHTOJCA E DYTE**

**E MARREVESHJES**

**Në lidhje me projektimin dhe tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese (Rrugët dhe Urat) dhe ndërtimin e rrugës M15 të Infrastrukturës Zëvendësuese të Moglicës, e ndryshuar**

**date 14.02.2014**

Kjo Shtojce e dyte ("**Shtojca**") e marreveshjes "Në lidhje me projektimin dhe tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese (Rrugët dhe Urat) dhe ndërtimin e rrugës M15 të Infrastrukturës Zëvendësuese të Moglicës" ("**Marrëveshja e Infrastrukturës Zëvendësuese**") lidhet sot, me ___ dhjetor 2014, ndermjet:

1. (A) MINISTRIA E ENERGJISE DHE INDUSTRISE, (AUTORITETI KONTRAKTUES/*MEI*) DHE

   **(B) AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR (*ARA*),**

   dhe

2. **DEVOLL HYDROPOWER SH.A,** një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën Rr. "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center, Zyra nr. 1204, Tiranë, Shqipëri dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit e Republikës së Shqipërisë me NUIS K82418002C **(DHP),**

Secili prej Autoritetit Kontraktues/MEI, ARA dhe DHP do të quhen individualisht "**Pala**" dhe bashkërisht "**Palët**". Çdo fjalë me gërmë të madhe e cila nuk është përkufizuar në kete Shtojce do të ketë kuptimin qe i është dhënë kësaj fjale në Marrëveshjen e Infrastrukturës Zëvendësuese dhe Kontratën e Koncesionit, siç përkufizohet më poshtë.

**HYRJE**

**MEQENËSE:**

(A) Më datë 14.02.2014, Palët nënshkruan Marrëveshjen e Infrastrukturës Zëvendësuese, sipas të cilës, DHP mori përsipër projektimin, tenderimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese nëse palët do të nënshkruanin një shtesë të Marrëveshjes së Konçesionit të Devollit, ku do te parashikohej që DHP do të merrte përsipër përgjegjësine për këto aktivitete nga Autoriteti Kontraktues/MEI në rrethana të caktuara.

(B) Neni 4.2 i Marrëveshjes së Infrastruktures Zëvendësuese, i ndryshuar me Shtojcen e Pare, parashikon se Autoriteti Kontraktues/MEI zotohet të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme me qëllim që shtesa e kësaj Marrëveshje të Konçesionit, siç është rënë dakord paraprakisht ndërmjet palëve, të miratohet nga qeveria shqiptare dhe të ratifikohet nga Parlamenti shqiptar jo më vonë se data 30 Dhjetor 2014.

(C) Në datën e nënshkrimit të kësaj Shtojce te Dyte, Palët kane nenshkruar Shtesën e 3-te te Kontratës së Koncesionit, por ajo nuk eshte ratifikuar ende nga Parlamenti, per rrjedhoje ka nevoje qe te shtyhet afati per ratifikimin e kesaj Shtese te 3-te të Marrëveshjes së Konçesionit.

(D) Meqenese punimet e ndertimit per Rrugen Zevendesuese Banje – Gramsh dhe Uren e Trashovices duhet te fillojne sa me shpejt te jete e mundur, perpara ratifikimit nga Parlamenti te Shteses se 3-te dhe publikimit te saj ne Fletoren Zyrtare.

(E) Palet konfirmojne se ata bien dakord qe Marrëveshja e Infrastrukturës Zëvendësuese do te mbetet e vlefshme dhe ne fuqi ne periudhen nga 30 dhjetor 2014 deri ne momentin e ratifikimit te Shteses se 3-te te Marreveshjes se Koncesionit nga Parlamenti dhe publikimit te saj ne Fletoren Zyrtare, nepermjet shtyrjes se afatit te Marrëveshjes se Infrastrukturës Zëvendësuese.

(F) Palët konfirmojnë se njoftimi per fillimin e punimeve te ndertimit per Infrastrukturen Zevendesuese Rruga Banje – Gramsh dhe Ura e Trashovices do te dergohet nga DHP pasi Keshilli i Ministrave te miratoje Shtesen e 3-te. Kostot e kryera nga DHP per keto punime do te merren persiper nga MEI, nese Parlamenti vendos te mos e ratifikoje Shtesen e 3-te.

**PËR KËTË ARSYE**, duke marrë parasysh sa më lart, Palët bien dakord si vijon:

**1. NDRYSHIMET**

**1.1 Neni 4.2 i Marrëveshjes së Infrastrukturës Zëvendësuese, e ndryshuar, behet si vijon:**

"4.2 Autoriteti Kontraktues/MEI zotohet të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme me qëllim që kjo shtesë e Marrëveshjes së Konçesionit, siç është rënë dakord paraprakisht ndërmjet Palëve, të miratohet nga qeveria shqiptare dhe të ratifikohet nga Parlamenti shqiptar jo më vonë se data 31 mars 2015".

**1.2 Ne Hyrje, tek shkronja (G), pika (iii) Te kryeje ndertimin e Infrastruktures Zevendesuese te meposhtme, do te shtohet germa b) si me poshte:**

*b) Fillimi i ndertimit per Rrugen Zevendesuese Banje - Gramsh dhe Uren e Trashovices;*

*Palet bien dakord se kjo Marreveshje, miratimi i projektit nga ARA, nenshkrimi i Shteses se 3-te te Marreveshjes se Koncesionit nga palet e kesaj Marreveshjeje dhe miratimi i Shteses se 3-te nga Keshilli i Ministrave do te jene kusht per nenshkrimin e kontratave te ndertimit dhe leshimin e Njoftimit per Veprim per fillimin e punimeve te ndertimit te Rruges Zevendesuese Banje - Gramsh dhe Ures se Trashovices.*

*ARA do te monitoroje dhe kontrolloje ndertimin e ketyre veprave derisa veprat e perfunduara t'i dorezohen ARA-s. Ne te njejten kohe, çdo ndryshim nga projekti i miratuar dhe pjesa teknike e dokumentave te tenderit, perfshire termat e references dhe specifikimet teknike do te jete subjekt i miratimit paraprak nga ARA.*

**1.3 Ne Nenin 3 behen ndryshimet e meposhtme:**

- Titulli ndryshohet si vijon: **NDERTIMI I RRUGES ZEVENDESUESE MOGLICE M15 DHE FILLIMI I PUNIMEVE PER RRUGEN ZEVENDESUESE BANJE –GRAMSH DHE UREN E TRASHOVICES**
- Ne nenin 3.1, shtohet nje fjali e re ne fund:

*"DHP do te filloje ndertimin e rruges zevendesuese Banje - Gramsh dhe Ures se Trashovices me kusht qe Shtesa e 3-te do te ratifikohet nga Parlamenti shqiptar. Nese Shtesa e 3-te nuk ratifikohet nga Parlamenti brenda dates 31 mars 2015, DHP do t'i kerkoje MEI-t me shkrim pagesën e te gjithe shumave te paguara dhe te pagueshme nga DHP sipas kontratave te*

*ndertimit per Rrugen Zevendesuese Banje - Gramsh dhe Uren e Trashovices, duke perfshire shumat e pagueshme ne rast te zgjidhjes se ketyre kontratave, si rrjedhoje e mosratifikimit te Shteses se 3-te nga Parlamenti dhe MEI do te kryeje kete pagese brenda 30 ditesh nga njoftimi".*

- Neni 3.2 ndryshohet si vijon:

  *"Punimet e ndertimit per Rrugen Zevendesuese Moglice M15, Rrugen Zevendesuese Banje - Gramsh dhe Uren e Trashovices do te kryhen ne perputhje me standardet teknike te miratuara dhe nga entitete te liçensuara".*

**2. MOSHEQJA DORE**

Asgjë sipas kësaj Shtojce të Marrëveshjes së Infrastrukturës Zëvendësuese nuk do të shkarkojë Autoritetin Kontraktues/MEI nga përgjegjësitë e tij sipas Marrëveshjes së Konçesionit, duke përfshirë por pa u kufizuar në përgjegjësinë për ndërtimin brenda afatit të Infrastrukturës Zëvendësuese.

**3. TE NDRYSHME**

Kjo Shtojce nënshkruhet në 3 kopje origjinale në gjuhën angleze dhe 3 kopje origjinale në gjuhën shqipe. Në rast mospërputhje midis dy versioneve, versioni anglisht do të mbizotërojë.

Asnjë dispozitë e Marrëveshjes, përveç atyre qe percaktohen shprehimisht ne kete Shtojce, nuk do të preken nga kjo Shtojce dhe se të gjitha dispozitat e tjera do të kenë të njëjtën fuqi dhe do të aplikohen sipas përcaktimeve të bëra në Marrëveshje.

Kjo Shtojcë është nënshkruar në mënyrë të rregullt nga përfaqesuesit e autorizuar të Palëve si më poshtë, në daten, muajin dhe vitin të përcaktuar me lart.

**MINISTRIA E ENERGJISE DHE INDUSTRISE**

**E REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

Nga:________________

Emri: ________________

Pozicioni: ________________

**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**

Nga:________________

Emri: ________________

Pozicioni: ________________

**DEVOLL HYDROPOWER SH.A**

Nga:________________

Emri: ________________

Pozicioni: CEO / Project Director

# Shtojca IV – Grafiku I Punimeve per zbatimin e veprimeve/detyrave perfshire ne Seksionin e ri 7.2.7.8 dhe7.2.7.9 te Marreveshjes se Koncesionit.

| Milestones per Miratimet | | | 2014 (J F M A M J J A S O N D) | 2015 (J F M A M J J A S O N D) | 2016 (J F M A M J J A S O N D) | 2017 (J F M A M J J A S O N D) | 2018 (J F M A M J J A S O N D) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Miratimi I Shteses se 3-te te Marreveshjes se Koncesionit nga Keshilli Ministrave | | | | | | | |
| Ratifikimi ne Parlament I Shteses se 3-te te Marreveshjes se Koncesionit . | | | | | | | |

| Rruga Zevendesuese nga Banja ne Gramsh dhe Ura e Trashovices | | | 2014 (J F M A M J J A S O N D) | 2015 (J F M A M J J A S O N D) | 2016 (J F M A M J J A S O N D) | 2017 (J F M A M J J A S O N D) | 2018 (J F M A M J J A S O N D) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pergjegjesite | DHP | GoA | | | | | |
| Projekti- Ideja li cili perfshin alternativa dhe studimin e VNM-se se perfunduar | x | | | | | | |
| Dhenia e miratimimit nga Autoritetet Shteterore, ARrSh | | x | | | | | |
| Procesi I Marrjes se te drejtave mbi pronesise "Land Access"(Shprones. Kompens.) i perfunduar ne Dhjetor | x | x | | | | | |
| Miratimi I Lejeve dhe Licencave te perfunduara ne Janar | | x | | | | | |
| Perfundimi I procesit te Tenderit ne Nentor | x | | | | | | |
| Njoftimi per fituesin e Tenderit (Njoftimi per fillimin), pas Miratimit te Supplementit te 3-te nga Keshilli Ministrave | x | | | | | | |
| Ndertimi | | | | | | | |

| Rruga Zevendesuese Moglice M03 | | | 2014 (J F M A M J J A S O N D) | 2015 (J F M A M J J A S O N D) | 2016 (J F M A M J J A S O N D) | 2017 (J F M A M J J A S O N D) | 2018 (J F M A M J J A S O N D) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pergjegjesite | DHP | GoA | | | | | |
| Projekti- Ideja li cili perfshin alternativa dhe studimin e VNM-se se perfunduar | x | | | | | | |
| Dhenia e miratimimit nga Autoritetet Shteterore, ARrSh | | x | | | | | |
| Procesi I Marrjes se te drejtave mbi pronesise "Land Access"(Shprones. Kompens.) i perfunduar ne Shtator | x | x | | | | | |
| Miratimi I Lejeve dhe Licencave te perfunduara ne Shtator | | x | | | | | |
| Perfundimi I procesit te Tenderit ne Tetor | x | | | | | | |
| Njoftimi per fituesin e Tenderit (Njoftimi per fillimin) | x | | | | | | |
| Ndertimi | | | | | | | |

| Rruga Zevendesuese Moglice M15 | | | 2014 (J F M A M J J A S O N D) | 2015 (J F M A M J J A S O N D) | 2016 (J F M A M J J A S O N D) | 2017 (J F M A M J J A S O N D) | 2018 (J F M A M J J A S O N D) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pergjegjesite | DHP | GoA | | | | | |
| Ndertimit | | | | | | | |

12) *Kopje të çdo fature tjetër ose dokumentacioni të Kostos së Infrastrukturës Zëvendësuese;*

13) *Pasqyrë/tabelë nga Shoqëria e Projektit ku përmbahen të dhëna për llogaritjen e çdo kamatë vonese sipas pikës b) të Nenit 7.2.7.5 të Kontratës se Konçesionit.*

**(ii) Dokumenta që tregojnë shumën e paguar ose kompensuar sipas Neneve 7.2.7.5 dhe 7.2.7.6 të Kontratës së Konçesionit**

1) *Pasqyrë/tabelë nga Shoqëria e Projektit e Késteve të Pagesës të kryera;*

2) *Pasqyrë/tabelë nga Shoqëria e Projektit të çdo shume të Kostos së Infrastrukturës Zëvendësuese të kompensuar kundrejt Tarifës së Konçesionit të pagueshme sipas Nenit 4.1 të Kontratës së Konçesionit;*

3) *Pasqyrë/tabelë nga Shoqëria e Projektit për çdo shumë të Kostos së Infrastrukturës Zëvendësuese të kompensuar kundrejt Taksave të Pagueshme dhe e shoqëruar me një kopje të konfirmimit të lëshuar nga autoritetet kompetente për shumën e kompensimit;*

4) *Pasqyrë/tabelë nga Shoqëria e Projektit ku tregohet shuma e papaguar e Kostos së Infrastrukturës Zëvendësuese.*

**Aneks V:** Informacioni/dokumentacioni i kërkuar sipas Nenit 7.2.7.7 te Kontratës së Konçesionit (e ndryshuar me Shtesën e 3-të të Kontratës së Konçesionit).

(i) **Dokumentat që duhet t'i paraqiten Autoritetit Kontraktues për Kostot e Infrastrukturës Zëvendësuese të kryera:**

1) *Kërkesë për rimbursim nga Shoqëria e Projektit që përmban një përmbledhje të hollësishme të Kostove të Infrastrukturës Zëvendësuese të kryera;*

2) *Kopje të urdhër pagesave për qëllimin e shpronësimit(ve) të truallit;*

3) *Pasqyrë/tabelë e Shoqërisë së Projektit për shpenzimet sociale dhe ambientaliste;*

4) *Kopje të faturave dhe urdhër pagesave për shpenzimet sociale dhe ambientaliste;*

5) *Kopje të kontratave të lidhura me Kontraktorët e Infrastrukturës Zëvendesuese;*

6) *Kopje të Situacioneve Progresive të Punimeve të lëshuara nga Kontraktorët e Infrastrukturës Zëvendësuese dhe të bashkë-nënshkruara nga një përfaqësues i Autoritetit Rrugor Shqiptar, në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në paragrafin e fundit të nenit 3 të Shtesës së 3-të të Kontratës së Konçesionit;*

7) *Kopje të faturave të lëshuara nga Kontraktorët e Infrastrukturës Zëvendësuese për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese;*

8) *Dokumentacion nga Shoqëria e Projektit për kostot e veta në lidhje shpenzimet per mbikëqyrje/manaxhim te kontratave. Këtu përfshihen dietat dhe shpenzimet e lidhura me kryerjen e punes dhe kostoja per ore pune e personelit e dokumentuar nga pershkrimi i punës së punëmarrësit. Kosto e orës së punës për person do të llogaritet bazuar ne pagën përkatëse dhe shpenzimet e përgjithshme administrative të dokumentuara nga analizat e kostove të shpenzimeve të përgjithshme administrative.*

9) *Kopje të faturave për kërkimet gjeologjike bashkë me kopje të urdhër pagesave;*

10) *Kopje të çdo urdhër pagese për tarifa të ndryshme të paguara ndaj Organeve Publike;*

11) *Kopje të kontratave të sigurimit, faturat për kostot e sigurimit dhe urdhër pagesa përkatëse;*